



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.Sh II.nr.1340/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Rient Sh.P.K., me seli në Prizren, rr. “Ukë Bytyqi”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ronexx Sh.P.K., me seli në Suharekë, me pronar O. H., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1981/23 të datës 20.05.2024, me datë 20.12.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Rient Sh.P.K., me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1981/23 i datës 20.05.2024, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1981/23 të datës 20.05.2024, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Ronexx Sh.P.K, dhe ka Shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr. 669/23 i datës 17.10.2023 të Përmbaruesit Privat Bardh Tasholli.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, duke propozuar që

aprovohet si e bazuar ankesa e Kreditorit, te Prishet aktvendimi i atakuar, dhe çështja të kthehet ne riprocedurë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Rient Sh.P.K., me seli në Prizren, ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Ronexx Sh.P.K., me seli në Suharekë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës 22-SHV01-004-10 e datës 18.03.2020.

Përmbartuesi privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim, ka nxjerr Urdhrin përmbartimor P.nr.669/23 dt.17.10.2023 me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 20,500.09 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 30.12.2022, e deri në pagesën definitive, si shpenzimet e procedurës përmbartimore në lartësi prej 312.00€.

Debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përmbartueshmërisë. Borxhin e ka përmbush me rastin e barazimit final me kreditorin meqenëse palët kanë arritur marrëveshjen për të kompensuar njëra tjetrën për furnizimet e bëra gjatë periudhës 2020-2023. Fatura e cila kërkohet të ekzekutohet është përfshirë në këtë barazim, pasi është lëshuar brenda kësaj periudhe. I ka propozuar gjykatës që aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor të anuloj.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se fatura paraqet dokument të besueshëm dhe i plotëson të gjitha elementet sipas nenit 29 të LPP-së. I propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.1981/23 dt.20.05.2024, me të cilin e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr. 669/23 i datës 17.10.2023 të Përmbartuesit Privat.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se fatura nr.22-SHV01-004-10 dt.18.03.2020, mbi bazën e së cilës është paraqitur propozimi për përmbartim, nuk është deponuar në origjinal apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së. Përmbartuesi privat në këtë çështje përmbartimore, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 38 par.2 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 22-SHV01-004-10 dt.18.03.2020 të lëshuar nga kreditori, e cila nuk përmbanë elementet që kërkohen me nenin 37 të LPP-së në të cilin parashihet se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, e po që se i referohemi propozimit për përmbartim të ushtruar nga ana e kreditori, rezulton se i njëjti është bërë duke u referuar në dokumentin përmbartues i cili nuk është dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar, siç përcakton ligji, por është dorëzuar në kopje, andaj si i tillë nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbartimit.

Andaj, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë

konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të dokumentit të lëshuar nga kreditori, i cili dokument nuk përmbanë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 të LPP-së.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka pranuar prapësimin, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumenteve përmbartimore. Kjo gjykatë vlerësoi se nuk janë të bazuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar të urdhëroj përmbartuesin privat t,ia dorëzoj gjykatës dokumentin në origjinal, për arsye se sikurse u theksua si më lartë, dokumenti i besueshëm në këtë rast fatura si dokument përmbartimor, nuk është dorëzuar në origjinal sikurse e parasheh ligji.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.1340/24 datë. 20.12.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha